

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.11

12 shkurt

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Udhëzim i MB
nr. 67, datë 6.2.2009

Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për
Kuvendin e Shqipërisë.....

885

Udhëzim i MF dhe MD
nr.13, datë 12.2.2009

Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të
administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë,
noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.....

893

UDHËZIM
Nr. 67, datë 6.2.2009

**PËR PROCEDURAT E HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE PËR
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 48, 49, 50, 52, 54 dhe 59 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të dekretit nr. 6008, datë 14.01.2009 të Presidentit të Republikës "Për caktimin e datës të zgjedhjeve për Kuvendin",

UDHËZOJ:

1. DPGJC, bazuar në të dhënat e RKGJC, vë në dispozicion të të gjitha bashkive/komunave/njësive bashkiake për Tiranën, listat e zgjedhësve për çdo ZGJC. Listat janë të vlefshme në ndërfaqen grafike të RKGJC dhe shkarkohen *online* nga RKGJC. Një kopje elektronike e listave i vihet në dispozicion çdo ZGJC-je, së bashku me aplikimin kompjuterik të listës së zgjedhësve.

2. Lista e zgjedhësve është e grupuar sipas zonave të qendrave të votimit. Kufijtë e zonave të qendrave të votimit janë ato të zgjedhjeve të fundit.

Kryetari i bashkisë /komunës/njesisë bashkiake cakton vendndodhjen e saktë, adresën e plotë të qendrave të votimit, përgatit hartën e njësisë së qeverisjes vendore të ndarë me zonat e qendrave të votimit.

3. Në aplikimin kompjuterik të listës së zgjedhësve janë evidentuar zgjedhësit që e kanë qendrën e tyre të votimit të pasaktë; numri i qendrës së votimit nuk është në numrin e qendrave të votimit që i përkasin bashkisë/komunës/njesisë bashkiake, apo dhe gabime të tjera të konstatuara gjatë vendosjes së adresës zgjedhore; bosh, karaktere joshifrore.

4. Për të prodhuar listën paraprake nën autoritetin e kryetarit të bashkisë/komunës/njesisë bashkiake për Tiranën, zyrat e gjendjes civile veprojnë si më poshtë:

a. Verifikojnë nëse në listën e zgjedhësve ndodhen të gjithë shtetasit që në datën 28 qershor 2009 kanë mbushur 18 vjeç. Lëvizjet e shtetasve, si transferimet, martesat, vdekjet etj., të cilat kanë impakt në listën e zgjedhësve, por që nuk janë përditësuar në Regjistrin Kombëtar të Shtetasve, duhet të reflektohen menjëherë. Përditësimi do të kryhet me dy hapa: fillimisht do të përditësohen listat e zgjedhësve dhe më pas do të reflektohen të plotë këto veprime në sistemin *online* të RKGJC-së.

Pakësimet. Për të gjithë shtetasit që janë larguar nga ZGJC-ja (transferim, martesë, vdekje etj.), por që figurojnë në listën e zgjedhësve të njësisë, duhen hequr nga lista. Për ta realizuar këtë proces, në aplikimin kompjuterik të listës së zgjedhësve të shpërndarë me CD, fillimisht lokalizohet zgjedhësi (nëse është e nevojshme përdoret procedura e kërkimit), selektohet rekordi përkatës i këtij zgjedhësi dhe klikohet butoni "Hiq zgjedhës".

Shtesat. Për të gjithë shtetasit që kanë ardhur në ZGJC (transferim, martesë etj.), por që nuk figurojnë në listën e zgjedhësve të njësisë, ata duhen shtuar në listë. Për ta realizuar këtë proces, në aplikimin kompjuterik të listës së zgjedhësve të shpërndarë me CD, fillimisht lokalizohet zgjedhësi duke përdorur procedurën e kërkimit, selektohet rekordi përkatës i këtij zgjedhësi dhe klikohet butoni "Rregullo qendër votimi". Për këta zgjedhës do të korrigjohet kodi ZGJC, ku do të vendoset kodi respektiv i ZGJC-së, si dhe do të vendoset QV-ja e re brenda ZGJC-së së re.

Për më tepër referojuni pikës në vazhdim.

b. Saktësimi i numrit përkatës të qendrave të votimit për shtetasit që kanë numrin e qendrave të votimit të vendosur gabim. Këta shtetas janë të evidentuar dhe të grupuar në lista të veçanta brenda listës së zgjedhësve të njësisë. Saktësimi i numrit të qendrës së votimit bëhet si më poshtë:

Kriteret që do të ndiqen për caktimin e QV-së janë:

Zgjedhësi vendoset në atë QV, brenda së cilës ndodhet adresa e tij e banimit. Për këtë:

i) Në rast se pjesëtarë të tjerë të familjes kanë një QV të vlefshme, e njëjta QV i vendoset edhe këtij zgjedhësi.

ii) Në rast se Regjistri Themeltar ku figuron i regjistruar shtetasi, përmban zgjedhës në të njëjtën QV ose pjesa dërmuese e tyre ndodhen në të njëjtën QV, e njëjta QV i vendoset edhe këtij

zgjedhësi.

iii) Në rast se asnjë nga rastet e mësipërme nuk aplikohet, kryetari urdhëron vendosjen e të gjithë zgjedhësve që kanë të pamundur adresën e tyre zgjedhore, në një qendër të përbashkët votimi, mundësisht në qendër të njësisë përkatëse.

Të gjitha rregullimet e QV-ve të shpjeguara në pikat e mësipërme, do të kryhen në aplikimin kompjuterik të listës së zgjedhësve të shpërndarë me CD, të shpjeguara në detaje në aneksin 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Pasi të ketë përfunduar korrigjimi i QV-ve dhe përditësimi i listës me shtesat dhe pakësimet, ky informacion kopjohet elektronikisht në CD dhe i dërgohet DPGJC-së, jo më vonë se data 24 shkurt 2009.

DPGJC reflekton të gjitha ndryshimet e kryera në përbërësit zgjedhorë të zgjedhësve nga ZGJC-të në Regjistrin Kombëtar të Shtetasve, brenda datës 27 shkurt 2009.

c. Përditësimi i RKGJC-së. Punonjësit e ZGJC-ve duhet të hedhin në sistemin *online* të RKGJC-së të gjitha aktet dhe veprimet e paflektuara në sistem. Rregullimet e qendrave të votimit janë reflektuar automatikisht në sistem, pasi ZGJCja ka dorëzuar CD e listës në DPGJC.

Në RKGJC pasqyrohen të gjitha përditësimet e kryera në pikën 4/a të këtij udhëzimi gjatë përditësimit të listës. Për këtë punonjësi i ZGJC-së duhet të ndjekë hapat e mëposhtme:

i) Regjistrohen në sistemin e RKGJC-së shtetasit që figurojnë të regjistruar në Regjistrat Themeltarë në këtë zyrë, por që nuk figurojnë në sistemin qendror (kjo mund të ketë ardhur p.sh. si pasojë e *data entry*). Për të regjistruar një shtetas në RKGJC referoju aneksit 2 “Krij person”.

ii) Për të gjithë zgjedhësit që kanë nevojë për korrigjime në përbërësit e gjendjes civile, korrigjime këto që nuk mund të kryhen nga aplikimi i listës së zgjedhësve, duhet të realizohen në sistemin *online* të RKGJC-së. Në varësi të rastit nëse shtetasi duhet të korrigjojë emrin, mbiemrin apo përbërës të tjerë do të përdoret një nga dy funksionet e sistemit që jepen të detajuara në aneksin 2 “Ndrysho person” dhe “Ndrysho emrin”.

iii) Për të gjitha rastet e shtetasve që janë hequr nga lista, sepse kanë vdekur, ky veprim do të kryhet në sistemin *online* të RKGJC-së. Për këtë do të përdoret një nga procedurat që parashikon sistemi “Akt vdekje” ose “Ndrysho person”.

iv) Për transferimet e ardhura në ZGJC, ky veprim do të kryhet në sistemin *online* të RKGJC-së. Për këtë do të përdoret procedura që parashikon sistemi “Regjistro vendbanimin”.

5. Zyra e gjendjes civile në bashki/komunë/njësi bashkiake, me urdhër të kryetarit, printon, nga RKGJC-ja, listën paraprake të shtetasve, sipas përcaktimeve të bëra në pikën b të nenit 49, të cilët në datën 28.6.2009 mbushin moshën 18 vjeç. Lista paraprake përmban: emër, atësi, mbiemër, datëlindje, kodin e banesës (kodin 10 shifror).

Lista paraprake do të gjenerohet në sistemin *online* të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile. Nga sistemi i RKGJC-së përgjegjësi i ZGJC-së shkarkon listën paraprake dhe e printon atë. Detajet jepen në aneksin 3 “Lista e zgjedhësve”.

Kjo listë do të dorëzohet, e nënshkruar nga përgjegjësi i ZGJC-se, kryetarit të bashkisë/komunës/njësisë bashkiake përkatëse, brenda datës 28.2.2009, sipas modelit nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Kryetari i bashkisë/komunës/njësisë bashkiake, pasi merr listën paraprake të zgjedhësve nga zyra e gjendjes civile, e nënshkruan këtë listë me datë 28.2.2009.

7. Kryetari i bashkisë/komunës/njësisë bashkiake bën shpalljen e listës paraprake brenda datës 6 mars, pranë zyrave përkatëse dhe për çdo qendër votimi, sipas rregullave të përcaktuara në pikën (c) të nenit 49 të Kodit Zgjedhor.

8. Kryetari i bashkisë/komunës/njësisë bashkiake, brenda datës 5 prill 2009, bën njoftimin me shkrim të zgjedhësve të përfshirë në listat e qendrave të votimit brenda territorit të bashkisë/komunës/njësisë bashkiake përkatëse.

Njoftimi për shtetasit do të jetë sipas modelit nr.2 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, brenda datës 5.3.2009, bën shpalljen e listës paraprake të zgjedhësve në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme.

9. Gjatë periudhës 6.3.2009 deri më 30.4.2009 kryetarët, së bashku me nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile, mbledhin kërkesat dhe bëjnë ndryshime për shkaqet e parashikuara në nenin 51 dhe sipas procedurave të përcaktuara në nenin 52 të këtij kodi.

Kërkesa për ndryshime në listën paraprake do të kryhet nëpërmjet formularit, sipas modelit nr.3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

10. Hartimi i listave të zgjedhësve në institucionet e posaçme do të ndjekë këtë kalendar veprimi:

a) Komandantët e reparteve brenda datës 14.5.2009 përgatisin dhe i dorëzojnë kryetarit të bashkisë/komunës/njesisë bashkiake, brenda territorit të së cilës ndodhen, listën emërore të zgjedhësve, që do të ndodhen në repart gjatë ditës së zgjedhjeve.

b) Drejtuesit e burgjeve dhe të vendeve të paraburgimit brenda datës 19.05.2009 përgatisin dhe i dorëzojnë kryetarit bashkisë/komunës/njesisë bashkiake, brenda territorit të së cilës ndodhet ky institucion, listën emërore të të gjithë zgjedhësve, që do të ndodhen në institucion gjatë ditës së zgjedhjeve.

c) Drejtuesit e institucioneve shëndetësore që pranojnë pacientë për një periudhë më shumë se 10 ditë, brenda datës 28 maj 2009 përgatisin dhe i dorëzojnë kryetarit të bashkisë/komunës/njesisë bashkiake listën emërore të zgjedhësve, që do të ndodhen në institucion gjatë ditës së zgjedhjeve.

Lista emërore e zgjedhësve sipas pikave (a), (b) dhe (c) do të hartohet në letër dhe elektronikisht në përputhje me aplikimin elektronik dhe formularin model 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

11. Kryetarët e bashkive/komunave/njësive bashkiake për rastet e listave sipas germës (a) të pikës 6, brenda datës 19.5.2009 përfshijnë emrat në listën përfundimtare të zgjedhësve.

Sipas germës (b) të pikës 6, brenda datës 24.5.2009 përfshijnë emrat në listën përfundimtare të zgjedhësve.

Sipas germës (c) të pikës 6, brenda datës 29.5.2009 përfshijnë emrat në listën përfundimtare të zgjedhësve.

Përfshirja në listën e zgjedhësve realizohet nga ZGJC-të duke vendosur adresën e re zgjedhore në RKGJC.

Bashkitë/komunat/njësitë bashkiake dërgojnë në letër dhe në aplikim elektronik një kopje të listave të institucioneve të posaçme.

Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore vendosin për hapjen e qendrave të reja të votimit në përputhje me nenin 62 të Kodit Zgjedhor.

12. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, pasi ka marrë listat nga bashkitë/komunat/njësitë bashkiake, për zgjedhësit në institucionet e posaçme, brenda datës 25.5.2009, u dërgon listën emërore të zgjedhësve që janë përfshirë në listën e zgjedhësve të institucioneve të veçanta dhe u kërkon heqjen e tyre nga lista e zgjedhësve në njësinë përkatëse, (njofton njësitë vendore për heqjen e tyre nga lista përkatëse).

Ndërsa për zgjedhësit e parashikuar në germën (c) të pikës 6, ky veprim do të kryhet brenda datës 29.5.2009.

13. Zyra e gjendjes civile në bashki/komunë/njësi bashkiake printon listën përfundimtare të shtetasve, të cilët në datën 28.6.2009 mbushin moshën 18 vjeç.

Lista përfundimtare do të gjenerohet në sistemin *online* të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile. Nga sistemi i RKGJC përgjegjësi i ZGJC-së shkarkon listën përfundimtare dhe e printon atë. Detajet jepen në aneksin 3 “Lista e zgjedhësve”. Kjo listë do t’i dorëzohet, e nënshkruar nga përgjegjësi i ZGJC-së, kryetarit të bashkisë/komunës/njesisë bashkiake përkatëse, brenda datës 29.5.2009. Printimi i listave përfundimtare kryhet për efekt të përfshirjes së ndryshimeve dhe shmangies së dublimeve pas konfirmimit përfundimtar nga DPGJC. Në çdo rast lista përfundimtare ka datën kur gjenerohen nga RKGJC. Kryetari i firmos dhe ia dërgon në tri format e përcaktuara sipas pikës (2) të nenit 54 të këtij kodi, KZAZ-së.

Përgjegjësi i ZGJC-së informon për ecurinë e procesit të shpalljes së listës DPGJC-në dhe në rast se kryetari nuk zbaton afatet e përcaktuara, DPGJC, në zbatim të pikës 3 të nenit 54, brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit bën shpalljen e listës përfundimtare dhe e dërgon pranë KZAZ-së.

14. Një kopje e listës përfundimtare në format elektronik dhe e printuar i dërgohet dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

DPGJC një kopje të kësaj liste në format elektronik e publikon brenda datës 3.6.2009 dhe në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Brendshme.

15. Ndryshimet në lista pas shpalljes së listës përfundimtare bëhen në përputhje me nenin 55 të këtij kodi.

16. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen kryetarët e bashkive/komunave/njësive bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, punonjësit e ZGJC-ve në bashki/komuna/njësi

bashkiake dhe institucionet e tjera shtetërore, që parashikohen në Kodin Zgjedhor.
17. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

Modeli nr.1

**LISTA PARAPRAKE E ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME PËR
KUVENDIN E SHQIPËRISË**

Bashkia/Komuna: _____

DATA E ZGJEDHJEVE: 28/06/2009

QARKU: _____

Qendra e votimit nr.: _____

Adresa: _____.

Nr.	Emri	Mbiemri	Atësia	Datëlindja	Adresa shifrore zgjedhore		
					Kodi i z.gj.c.	Kodi Q.V.	Numri i ndërtesës

QARKU: _____

DATA E ZGJEDHJEVE: 28/06/2009

Bashkia/Komuna: _____

Numri i banesës: __

Ju njoftojmë se për zgjedhjet ne Kuvendin e Shqiperise, ju jeni të regjistruar në listën paraprake të qendrës së votimit numër _____, me adresë: _____

Kryetari

Firma _____

QARKU: _____

DATA E ZGJEDHJEVE: 28/06/2009

Bashkia/Komuna: _____

Numri i banesës: __

Ju njoftojmë se për zgjedhjet ne Kuvendin e Shqiperise, ju jeni të regjistruar në listën paraprake të qendrës së votimit numër _____, me adresë: _____

Kryetari

Firma _____

QARKU: _____

DATA E ZGJEDHJEVE: 28/06/2009

Bashkia/Komuna: _____

Numri i banesës: __

Ju njoftojmë se për zgjedhjet ne Kuvendin e Shqiperise, ju jeni të regjistruar në listën paraprake të qendrës së votimit numër _____, me adresë: _____

Kryetari

Firma _____

KËRKËSE
PER NDRYSHIME NE LISTEN PARAPRAKE

Unë / pjesëtar i trungut familjar të/ person i tretë i _____ me numër
ID _____ banor i _____ me adresë _____ kërkoj ndryshimin në
listën paraprake për shkakun
se _____. Kjo
provohet nëpërmjet dokumentit që paraqes në zyrën e gjendjes civile
si _____ lëshuar me datë _____ që disponoj . Kjo kërkesë u
dorëzua në zyrën e gjendjes civile të _____ sot me datë ____/____/2000.
Kërkesa mbahet në dy kopje, një kopje për kërkuesin dhe një kopje për Kryetarin e Njesisë
Vendore përkatëse.

KERKUESI

PERGJEGJESI I ZGJC NJESIA _____

Firma

Firma

LISTA E ZGJEDHËSVE NË INSTITUCIONET E VEÇANTA

KOMANDA E REPARTIT USHTARAK NR_____

DREJTORIA E BURGUT/PARABURHIMIT_____ QENDRA

SHENDETËSORE/SPITALI_____

DREJTUAR NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE_____

DËRGOJMË LISTËN EMRORE TË ZGJEDHËSVE TË INSTITUCIONIT PËR
ZGJEDHJET E KUVENDIT TË SHQIPËRISË, DATË 28 QERSHOR 2009

NR	EMËR	MBIEMËR	ATËSIA	DATËLINDJA dd/mm/vvvv	NUMRI I IDENTITETIT	NJ.Q.V.NGA VJEN
1.						
2.						
3.						

DREJTUESI I INSTITUCIONIT_____

Firma

UDHËZIM
Nr.13, datë 12.2.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR VEPRIME E SHËRBIME TË
ADMINISTRATËS GJYQËSORE E MINISTRISË SË DREJTËSISË, PROKURORISË,
NOTERISË DHE ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë

UDHËZOJNË:

1. Tarifat për veprime e shërbime nga administratat gjyqësore dhe Ministrisë së Drejtësisë, prokurori, noteri caktohen sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Tarifat për veprime e shërbime që kryhen nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, caktohen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.549, datë 26.08.1996 “Për caktimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar”

3. Për vjeljen e tarifave për kryerjen e veprimeve e të shërbimeve administrative në gjykata, Ministrinë e Drejtësisë, prokurori dhe Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ngarkohen administratat përkatëse të këtyre institucioneve, ndërsa për tarifën e shërbimit noterial, ngarkohet “Posta Shqiptare” sh.a.

4. Këto tarifa paguhen në momentin e kryerjes së veprimeve dhe bëhen me anën e pullës për tarifën fikse ose me mandatarë për ato raste kur, kjo tarifë sipas shtojcës nr.1, bashkëlidhur, është shprehur në përqindje.

5. Termi “tarifë” në pikën 8 të shkronjës “A” të shtojcës 1, ka të njëjtin kuptim me termin “taksë mbi aktet” i përdorur në nenin 156 të Kodit të Procedurës Civile.

6. Pullat vendosen në çdo kopje të dokumentit të lëshuar, për të gjitha dokumentet që, sipas ligjit, duhet të pajisen me pulla. Dokumentet janë të vlefshme kur pulla është e vulosur nga organi që kryen shërbimin. Për plotësimin e vlerës së pullës për aktet që lëshohen mund të përdoren një ose më shumë pulla, me kusht që ato të plotësojnë vlerën e tarifës.

7. Në rast se personi kërkon kopje të akteve apo dokumenteve të lëshuara nga organet gjyqësore apo noteriale, vlera e pullës është përcaktuar në shtojcën nr.1, me kusht që tek akti ose dokumenti të jetë shënuar fjala "kopje". Në rast të kundërt merret vlera e plotë e tarifës.

8. Tarifa e paguar nuk kthehet kur hiqet dorë nga kryerja e veprimeve gjyqësore apo noteriale.

9. Institucionet përgjegjëse për vjeljen e tarifave me anën e pullës planifikojnë dhe porosisin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve pullat sipas nevojave.

10. Mbi tarifën e shërbimit të përfshira në këtë udhëzim nuk aplikohet TVSH.

11. Këto tarifa aplikohen në çdo rast pavarësisht tarifave të shërbimit, të parashikuara në akte të tjera ligjore apo nënligjore.

12. Për shërbimin e kryer, institucionet përkatëse të gjykatës, Ministrisë së Drejtësisë dhe prokurorisë përfitojnë 10% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në llogarinë përkatëse të thesarit, ndërsa Posta Shqiptare sh.a. përfiton komision në masën 3%.

13. Tarifat e arkëtuara dhe të derdhura në llogaritë përkatëse të thesarit i takojnë Buxhetit të Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTËR I DREJTËSISË
Enkelejd Alibeaj

**TARIFA PËR VEPRIMET DHE SHËRBIMET QË KRYHEN NGA ADMINISTRATA
GJYQËSORE, MINISTRIA E DREJTËSISË, PROKURORIA DHE NOTERIA**

		Masa e tarifës në lekë	Masa e tarifës në %
A.	Tarifa për veprime e shërbime që kryhen nga administrata gjyqësore e prokuroria:		
1.	Për lëshimin e vërtetimit se personi nuk ka pengesa ligjore për pajisjen me pasaportë për jashtë shtetit.	200	
2.	Për lëshimin nga gjykata të çdo kopje vendimi e çdo dokumenti që kërkohet nga të interesuarit.	200	
3.	Për lëshimin e dëshmisë së penaltetit nga zyrat e gjendjes gjyqësore	200	
4.	Për legalizimin e akteve të noterisë nga Ministria e Drejtësisë	200	
5.	Për lëshimin e vërtetimit se ndaj shtetasit nuk është filluar çështje penale nga prokuroria.	200	
6.	Për lëshimin e vendimit të pushimit ose të vendimit të mosfillimit të çështjes penale nga prokuroria	200	
7.	Për lëshimin e vërtetimit nga gjykata se kërkuesi nuk është në proces gjyqësor.	200	
8.	Kërkesëpadi që paraqiten në gjykatë:		
	a) për pension ushqimor	0	
	b) për vërtetim fakti	200	
	c) padi për zgjidhje martese	3000	
	ç) padi për pavlefshmëri të veprimeve juridike	3000	
	d) padi të rrjedhura nga marrëdhënie kontraktore, si dhe për shkaktim dëmi		
	I) me vleftë deri 100 000 lekë	3000	
	II) me vleftë mbi 100 000 lekë		1%
	dh) padi për pjesëtim pasurie	3000	
	e) padi për kthim në punë	0	
9.	Pranimi i ankimeve kundër vendimeve të gjykatës	200	

		Masa e tarifës në lekë	Masa e tarifës në %
B.	Tarifë për veprime që kryhen nga përmbaruesi gjyqësor:		
1.	Për vënien në ekzekutim të vendimeve e titujve të tjerë ekzekutivë me objekt të pavleftësueshëm	750	
2.	Për vënien në ekzekutim të vendimeve e titujve të tjerë ekzekutivë me objekt të vleftësueshëm:		
	a) kundrejt shtetasve		3%
	b) kundrejt personave juridikë		7%
3.	Për lajmërimet dhe veprimet e tjera të përmbaruesit gjyqësor	200	
4.	Për lëshime nga përmbaruesi gjyqësor të çdo lloj akti ose dokumenti të kërkuar nga të interesuarit	200	
5.	Për vënien në ekzekutim të vendimeve me objekt pension ushqimor	0	

		Masa e tarifës në lekë	Masa e tarifës në %
C.	Tarifa e pullës që zbatohet për veprimet që kryhen nga zyrat noteriale:		
1.	Përpilimi i testamenteve me akte noteriale	450	
2.	Depozitimi i testamenteve ollografe	200	
3.	Prokura (redaktim):		
	a) të përgjithshme	200	
	b) të posaçme	200	
4.	Për lëshimin e kopjeve, shkurtime e pjesë të akteve të depozituara në zyrën noteriale	200	
5.	Vërtetim se kopjet ose shkurtime të dokumenteve janë të njëjta me origjinalin	200	
6.	Vërtetim përkthimi dhe vërtetim njësie me origjinalin	200	
7.	Kontrata për kalim pronësie të pasurisë së luajtshme	700	
8.	Kontrata për kalim pronësie të pasurisë së paluajtshme	1000	
9.	Redaktimi i akteve noteriale të ndryshme	200	
10.	Njoftim dhe kujtesë noteriale ose akte të tjera jashtëgjyqësore	200	
11.	Legalizim i nënshkrimit të shtetasve në akte të ndryshme	200	
12.	Pranimi për ruajtje të dokumenteve të personave fizikë dhe juridikë në zyrat noteriale	300	
13.	Vërtetimi i qenies së një personi dhe qëndrimi i tij në një vend të caktuar	200	
14.	Kundërshtimi i çekut dhe kambialit (protesta)	200	
15.	Kontratë qiraje	200	
16.	Kontratë huaje	200	
17.	Kontratë sipërmarrje	200	
18.	Veprime të tjera noteriale	200	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 12.2.2009
Doli nga shtypi më 12.2.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 16 lekë